



BASHKIA MIRDITË

Nr. _____ Prot

Datë ____ .10.2025

NJOFTIM “Për vend të lirë pune ”

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore në RSH-së”, në Kodin e Punës të RSH-së i ndryshuar, Vendimin nr.02 datë 08.01.2024 “Për miratimin e strukturës organike të Bashkisë Mirditë për vitin buxhetor 2024” i ndryshuar me urdhër Nr.4 datë 08.01.2025, Bashkia Mirditë shpall vend të lirë pune:

1 (një) pozicion “Monitorues/Mbikëqyrës i pompave vaditëse” në fshatin Bukmirë – Agjencia e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Bashkia Mirditë

I- PËRSHKRIMI I PUNËS

1. Monitorimi i stacionit të pompave Shpërdhazë gjatë gjithë vitit;
2. Pastrimi i materialeve inerte nga vaskat për funksionimin e pompave;
3. Vënia në gatishmëri të pompave para fillimit të sezonit të ujitjes;
4. Kontrolli i funksionimit normal të elektropompave;
5. Ndezja dhe fikja e pompave për furnizimin me ujë të 3 (tre) depozitave në fshatin Bukmirë gjatë periudhës së ujitjes;
6. Komunikimi me punonjësin e ujitjes Bukmirë për ndezjen dhe fikjen e pompave;
7. Njoftimi i eprorëve për probleme në funksionimin e pompave.

II- DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë me postë apo drejtpërsëdrejti, në zyrën e protokollit pranë Bashkinë Mirditë, deri më dt. 12.11.2025 ora 15:00 dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë personale/ letër motivimi për vendin e punës
2. CV (Curriculum vitae)
3. Vërtetim nga prokuroria
4. Vërtetim nga gjykata
5. Raport aftësie për punë
6. Dëshmi penaliteti, lëshuar nga Ministria e Drejtësisë
7. Dëftesë e Shkollës së Mesme (fotokopje e noterizuar)
8. Fotokopje e letërnjoftimit elektronik

9. Librezë pune
10. Fotografi (2 copë)

Mungesa e një prej dokumenteve apo pavlefshmëria e tyre, sjell mos kualifikimin e kandidatit.

III- KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune janë:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të mos jetë në proces procedimi apo shqyrtimi penal në prokurori apo gjykatë;
- f) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

Intervista do të zhvillohet me datë 17.11.2025, ora 11:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, me adresë: Sheshi “Abat Doçi”, pranë “Godina e Shërbimit të Qytetarëve”, kati I-rë.

Për çdo paqartësi apo detaje më të hollësishme paraqituni pranë Njësine Përgjegjëse të Burimeve Njerëzore, Bashkia Mirditë.

BASHKIA MIRDITË
(Njësia Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore)